



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.102..... prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 12 / 08 / 2025

VENDIM

Nr. 23 date 12 / 08 / 2025

PËR

PROJEKT ZBATIMIN E RISHIKUAR TE OBJEKTIT

“Rehabilitim i digës së Tplan, Bashkia Tropojë”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 12.08.2025 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e rishikuar të paraqitur nga Bashkia Tropojë për Rehabilitimin e digës së Tplan në bashkinë Tropojë.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente “DERBI-E” dhe e dorëzuar në SKDM nga bashkia Tropojë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se në projektin e rishikuar mungon Raporti dhe llogaritjet e qendrueshmerise se digës në zonën e rreshqitjes të trupit të digës dhe për të gjithë trupin e digës pas rehabilitimit.

Keshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) i rekomandoi antarëve të KKDM të mos miratojnë Projekt zbatimin e rishikuar për shkak të mungesës së Raportit dhe llogaritjeve për qendrueshmerine e digës. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të mos miratojnë Projekt Zbatimin e rishikuar të paraqitur për Rehabilitimin e digës së Tplan në bashkinë Tropojë për shkak të mungesës së Raportit dhe llogaritjeve të qendrueshmerise se digës. Pas kryerjes së këtyre llogaritjeve për verifikimin e qendrueshmerise se digave dhe nëse bazuar në këto llogaritje nuk rezultojnë probleme për qendrueshmerine e digës pas rehabilitimit të saj, Shfrytëzuesi i digës mund të fillojë punimet emergjente për rehabilitimin e kësaj dige në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 të mesipërme
- 2- **Ti kërkoj Bashkisë Tropojë** si shfrytëzues i digës
 - Të plotësojë dokumentacionin teknik të projektit me Raportin dhe llogaritjet përkatëse për verifikimin e qendrueshmerise se digës si dhe plotësimin e kërkesave të VKM se mesipërme në lidhje me kontrollin e punimeve, dorëzimin e projektit të plotë të zbatimit pranë KKDM dhe krijimin e kushteve për kontrollin e punimeve nga ITD.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM dhe ITD për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

PER KOMITETIN KOMBËTAR TE DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

